- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

## **Neni 30 Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqet për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktajnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

## **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**

### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

## **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

## **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

## **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39                   Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40                   Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41                   Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42                   Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43                   Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 616-21-2707-5-1-1/C678

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <b>17.806,00 EUR ne afat prej 150 ditëve, ndërsa pas përfundimit te punimeve OE është i obliguar po ashtu ta beje sigurimin e ekzekutimit ne vlerën e njëjtë ne afat prej tre viteve i cili sigurim e mbulon edhe garancionin e punimeve – përgjegjësinë e defekteve.</b>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <b>15 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.</b>
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është <b>15 ditë kalendarike nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.</b>
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <b>15 dite pas nënshkrimit te kontratës</b>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: <b>75 ditë kalenderike.</b>

Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë <b>0.25%</b> e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.  Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është <b>10%</b> e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	<b>Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,</b>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është: do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim nga ZKA
Parimet e përgjithshme të pagesave	24	Autoriteti Kontraktues do të paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione në vlera minimale nga <b>30.000,00 €</b> apo edhe me tepër për punët e kryera dhe të konstatuara nga menaxheri i kontratës.
Parapagimi	26.1	Nuk aplikohet
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: <b>10%</b> i vlerës së kontratës.  Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK.  Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".  <b>Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve 3 vite</b>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë <b>15 ditë</b> kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuere e defekteve është <b>3 vite</b> e cila mbulohet me sigurim të ekzekutimit sipas pikës 10.1 të kushteve të veçanta
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është <b>përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.</b>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<b>Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë</b>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <b>Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</b>  ose  b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <b>Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të</b>



		<p>Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
--	--	--

Prokurimi: 616-21-2707-5-1-1

Nr i brendshëm: 616 21 076 511

Tituli: Rikonstruimi dhe ndertimi i rrugeve Malush Kosova, Ilir Konushevci, Ahmet Krasniqi, Gjergj Balsha dhe Toni Bler, Shkelzen Haradinaj - faza e II-te, Uran Ajeti, Aziz Abrashi

- 1 Rikonstruimi i rruges Malush Kosova
- 3 Rikonstruimi i rruges Ahmet Krasniqi
- 4 Rikonstruimi i rruges Gjergj Balsha dhe Toni Bler
- 5 Ndertimi i rruges Shkelzen Haradinaj - faza e II-te
- 6 Ndertimi i rrugeve Uran Ajeti

Kodi i tenderit: 616-21-2707-5-1-1

Data: 29.06.2021

#### Lista e dokumenteve të tenderit mbështetëse

---

Nr.	Dokument
1.	Plani Dinamik, vendimi mbi menaxherin, sigurimi.pdf
2.	Informatat gjenerale te kompanise Gashi Ing SHPK.pdf
3.	Qarkullimi prej Atksë 2018-2019-2020.pdf
4.	Lista e stafit dhe marrveshje me ing2.pdf
5.	Kontrata e puntoreve.pdf
6.	<b>Kontratat dhe procesverbalet e vitit 2018.pdf</b>
7.	<b>Kontratat dhe procesverbalet e vitit 2019.zip</b>
8.	<b>Kontratat dhe procesverbalet e vitit 2020.pdf</b>
9.	Aneksi6.pdf
10.	Paisjet Teknike Gashi Ing 2021_co.pdf
11.	Marrveshje me FAMIS.pdf
12.	Marrveshje me Mineral LLC.pdf
13.	Marrveshje për asfalt.pdf
14.	Marrveshje per Beton.pdf
15.	Marrveshje per Zhavor.pdf
16.	Iso standardet ma te reja.pdf
17.	Aneksi7.pdf
18.	Marrveshja me Auto LLapi.pdf

#### Përshkrimi i çmimeve

---

Nr	Emërtimi i grupit	Dokumenti
1.	Rikonstruimi i rruges Malush Kosova	LOTI 1.pdf
2.	Rikonstruimi i rruges Ahmet Krasniqi	Loti 3.pdf

3. Rikonstruimi i rruges Gjergj Balsha dhe Toni Bler LOTI 4.pdf
4. Ndertimi i rruges Shkelzen Haradinaj - faza e II-te LOTI 5.pdf
5. Ndertimi i rrugeve Uran Ajeti LOTI 6.pdf

**Pjesët e tenderit që do të dorëzohen ndaras:**

---

jo

## **AUTORITETI KONTRAKTUES**

---

**KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, TREPQES NR.2, -, PRISHTINË,**

**Zyrtari përgjegjes i prokurimit:**

**Nr i Prokurimit: 616-21-2707-5-1-1**

### **OPERATOR EKONOMIK:**

---

Emri i kompanisë dhe adresa e plote: **GASHI ING SH.P.K, Nebih Hodo Kuqi, Nr 3, 23000, Suharekë, Kosovë**

E-mail: **gashi\_ing@hotmail.com**

Personi kontaktues: **Enver gashi**

Telefoni: **044/183856**

Faxi:

Numri fiskal: **811280403**

**Grup i operatorëve ekonomik (nëse aplikohet):**

# FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

## Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 616-21-2707-5-1-1

**Titulli i kontratës: Rikonstruimi dhe ndertimi i rrugeve Malush Kosova, Ilir Konushevi, Ahmet Krasniqi, Gjergj Balsha dhe Toni Bler, Shkelzen HARadinaj - faza e II-te, Uran Ajeti, Aziz Abrashi**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

### 4 Rikonstruimi i rruges Gjergj Balsha dhe Toni Bler

3. Çmimi total i tenderit është:

**178 060,36 EUR**

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 90 nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës
6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender *[shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet]* si partner në konsorcium të udhëhequr nga *[shëno emrin e udhëheqësit]*. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.
7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK
8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e

rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

**Informacion në lidhje me nënkontraktorët**

Emri dhe adresa e nënkontraktorit	Numri fiskal - nënkontraktorë	Përshkrimi i pjesës së kontratës që do të nënkontraktohet	Pjesa vlera të nënkontraktohet	Përqindja e kontratës që do të nënkontraktohet (%)

PARAMASA DHE PARALLOGARIA RIKONSTRUIMI I RRUGËS TONI BLER

Gjatësia L=455.98m

Nr. rendor	pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
1.0		PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT				
1.1		Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në rrugë.	m'	455.98	0.10 €	45.60 €
1.2		Inçizimi gjeodezik i gjendjes egjistuse, harmonizimi i kotave ne hyrjet dalje ne vendëkalime dhe rrugë anësore pas perfundimit te punimeve te dorëzohet situacioni i rruges.	m'	455.98	0.10 €	45.60 €
1.3		Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë si dhe identifikimi i instalimeve nentokore gjate punimeve, ruajtja e tyre si dhe sanimi i tyre ne rast te dëmtimit.	m'	455.98	0.10 €	45.60 €
1.4		Demolimi dhe transporti deri në deponi i pllakave (kubzave) nga betoni dhe materialeve tjera të ngurta.	m <sup>2</sup>	1276.744	0.50 €	638.37 €
1.5		Prerja vjpre e asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta.	m'	911.96	0.50 €	455.98 €
1.6		Demolimi, rrenimi i rigolles nga betoni me gjersi 70cm dhe skajorit ekzistues me dimensione: 18x24 me shtresen betonit ekzistues nën skajore me dore dhe me makinerinë e duhurë pa u dëmtuar asfalti i cili kufizohet me skajorë, ngarkimi, transporti deri ne 15 km.	m'	210	0.50 €	105.00 €
1.7		Demolimi, rrenimi i skajoreve ekzistues me dimensione: 7x20 me shtresen betonit ekzistues nën skajore me dore dhe me makinerinë e duhurë pa u dëmtuar asfalti i cili kufizohet me skajorë, ngarkimi transporti deri ne 15 km.	m'	0	0.50 €	- €
1.8		Demolimi i shtyllave elektrike duke përfshir edhe transportin deri në deponi.	copë	4	15.00 €	60.00 €
1.9		Demolimi dhe transporti deri ne deponi i objekteve të ndryshme të betonit dhe materialeve tjera të ngurta siq janë muret, parapetet, kanali në formë trapezi dhe objekte tjera.	m <sup>3</sup>	166.5	1.00 €	166.50 €
1.10		Demolimi i gypave egjistues të kanalizimit dhe gypave tjer egjistues dhe transporti deri ne deponi.	m'	65	1.00 €	65.00 €
1.11		Demolimi i pusetave të ndryshme egjistuese me thellsi nga H=1.5-3.5m dhe largimi deri ne deponi.	copë	3	10.00 €	30.00 €
1.12		Demolimi i kapakave të pusetave ekzistues pa u demtuar, nivelizimi dhe vendosja jastëkut prej beton armes t=20cm me cement shpejtë lidhës ne niveleten projektuarre. Pas betonimi kapaket e pusetave duhet te rivendosen ne niveleten e projektuar.	copë	3	35.00 €	105.00 €
1.13		Demolimi i ujëmbledhësave ekzistues pa u demtuar, nivelizimi dhe vendosja jastëkut prej beton armes t=20cm me cement shpejtë lidhës ne niveleten projektuarre. Pas betonimi kapaket dhe ujëmbledhësat duhet te rivendosen ne niveleten e projektuar.	copë	1	25.00 €	25.00 €
1.14		Ngritja, nivelizimi dhe betonimi i kapakëve prej gjeze, për pesha të rënda për instalime të elektrikes ose telefonis. Në çmimi të flogaritit edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30 (atyre egjistuese).	copë	2	30.00 €	60.00 €
1.15		Demolimi i kapakve të dëmtuar dhe largimi deri ne deponi.	copë	3	5.00 €	15.00 €
1.16		Germimi i dheut të kategorisë: III, IV dhe V me makinë dhe dorë në raport (70 me 30%) për nderëtimin e murit mbrojtës dhe trotuareve (thellsi i -0.8 deri -1.5m) si dhe kompaktimi pas rrafshimit me modul të ngjeshjes Mv>30Mn/m <sup>3</sup> , në flogari hyn edhe transporti i dheut në deponi.	m <sup>3</sup>	745.2	0.70 €	521.64 €
1.17		Germimi i dheut të kategorisë: III, IV dhe V me makinë dhe dorë në raport (90 me 10%) pas heqjes së asfaltit në pikat ku kemi dëmtim të bazës së asfaltit në thellsi -70cm si dhe kompaktimi pas rrafshimit me modul të ngjeshjes Mv>30Mn/m <sup>3</sup> , në flogari hyn edhe transporti i dheut në deponi.	m <sup>3</sup>	1915.116	0.70 €	1,340.58 €
1.18		Furnizimi, transporti, punimi i materialit mbushes guror jokohorent me CBR>20%, shtrirje dhe ngjeshja në shtresa jo më të mdha se 30cm deri në modul in e ngjeshmërisë 50MN/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	820.764	2.00 €	1,641.53 €
1.19		Furnizimi, transporti dhe shtrirja e gjeotekstilit 400gr/m <sup>2</sup> në ikat ku kemi dëmtim të nënbazes.	m <sup>2</sup>	2192	1.20 €	2,630.40 €
1.20		Demolimi i shtresave egjistuese të asfaltit në pjeset ku kemi deformime në bazë të rrugës me trashësi t=15cm.	m <sup>2</sup>	616.0	0.50 €	308.00 €
1.21		Gryerja e shtreses finale dhe bituzhavorit egjistues në hapsiren e rruges me trashësi t=3-7cm.	m <sup>2</sup>	2279.9	0.50 €	1,139.95 €
1.22		Largimi i ullit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	orë	16	5.00 €	80.00 €
TOTAL PUNËT E DHEUT , DEMOLIMIT :						9,524.75 €

pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
--------------------------	---------------	--------	-------	-------------	------------------



2		PUNËT E TAMPONIT			
2.1	Furnizim, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>60MN/m <sup>2</sup> prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-60mm me trashësi t=40cm si bazë per vendosjen e themeleve të murit mbrojtës.	m <sup>3</sup>	729.568	2.00 €	1,459.14 €
2.2	Furnizim, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>80MN/m <sup>2</sup> prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-30mm me trashësi t=10cm si bazë per vendosjen e shiritit të këmbësorve (trotuareve).	m <sup>3</sup>	182.392	3.00 €	547.18 €
2.3	Furnizim, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit Mv>100MN/m <sup>2</sup> prej gurit të thyer gëlqeror me fraksion: 0-31.5mm me trashësi t=15cm si bazë per vendosjen e asfaltit.	m <sup>3</sup>	144	3.00 €	432.00 €
TOTAL PUNËT E TAMPONIT:					2,438.31 €





Nr. rendor	pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
<b>PUNËT E BETONIT DHE ASFALTIT</b>						
3	3.1	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve 18/24/80 me kualitet acc. EN1340:2003 nga klasa C30/37, M100 në shtresë betoni me trashësi t=12cm dhe klasë C16/20.	m'	912.0	4.80 €	4,377.41 €
	3.2	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve 7/20/50 me kualitet sipas acc. EN1340:2003 nga klasa C30/37 vendosur në shtresë betoni me trashësi t=10cm dhe klasë C16/20.	m'	911.96	3.00 €	2,735.88 €
	3.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i pllakave (kubzave) nga betoni me t=8cm, me C40/50, M100 per troruare sipas projektit duke përfshirë shtruarjen e rëres me trashësi t=5.0cm dhe mbushjen e fugave.	m <sup>2</sup>	1367.9	6.80 €	9,301.99 €
	3.4	Furnizimi dhe punimi i shtresës së binderagregatit: BZH 0-22 me trashësi t=8cm si dhe sterpikjen me emulzion 1.0kg/m2 në hapësirë ku kemi larguar asfaltin per forcim të bazës.	m <sup>2</sup>	912.0	8.30 €	7,569.27 €
	3.5	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfaltbetonit nga materiali i njëtrajtshëm AB11 me trashësi t=4,0cm.	m <sup>2</sup>	2,815.9	5.80 €	16,332.10 €
<b>TOTALI PUNËT E BETONIT DHE ASFALTIT</b>						<b>40,316.65 €</b>

Nr. rendor	pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
<b>PUNËT E MURIT MBROJTES</b>						
4	4.1	Furnizimi, transporti kallapimi vendosja kompaktimi i betonit të klasit C30/37 per murin mbrojtës.	m <sup>3</sup>	142.4	70.00 €	9,968.00 €
	4.2	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi, pastrimi dhe vendosja në veper e armaturës S500 me profil Ø10-14mm per murin mbrojtës.	kg	10680	0.85 €	9,078.00 €
